



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 72

2003

Gusht

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9125 datë 29.7.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 12.3.1996.....	3225
Ligj nr.9126 datë 29.7.2003	Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë.....	3245
Ligj nr.9128 datë 29.7.2003	Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension.....	
	Ndreqje gabimi.....	3257

L I G J
Nr.9125, datë 29.7.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7961, DATË 12.7.1995 “KODI I
PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8085, DATË
12.3.1996**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 12.3.1996, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Kodi i Punës bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 2

Në nenin 3, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Kontrata e punës rregullohet nga ligji i shtetit, ku punëmarrësi kryen zakonisht punën e vet, edhe nëse ai dërgohet nga punëdhënësi të punojë përkohësisht në një shtet tjetër.

2. Kur punëmarrësi nuk e kryen punën zakonisht në të njëjtin shtet, kontrata e punës rregullohet nga ligji i shtetit ku ndodhet qendra e tij/saj e punës.

Kur qendra e punës nuk mund të përcaktohet, ajo rregullohet nga ligji i shtetit, ku ndodhet qendra e personit fizik ose juridik, që ka punësuar punëmarrësin.”.

Neni 3

Në nenin 4 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Dispozita të veçanta të këtij Kodi zbatohen edhe ndaj personave, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për probleme të lidhura me marrëdhëniet e punës.”.

Neni 4

Në nenin 5, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) punët familjare që kryhen nga: bashkëshorti, fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, partnerët bashkëjetues, paraardhës të tyre, përfshirë të birësuarit, për aq kohë sa jetojnë me punëdhënësin në një ekonomi të përbashkët, me përjashtim të rasteve kur provohet se personat që i kryejnë ato janë punëmarrës.”.

Neni 5

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1, shkronja “a ” ndryshohet si më poshtë:

“a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.”.

- Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Punëmarrësi nuk mund të heqë dorë nga të drejtat, që rrjedhin nga dispozitat urdhëruese të këtij Kodi ose të kontratave kolektive të punës. Janë të vlefshme marrëveshjet e bëra në prani të inspektorit të punës ose në formën e parashikuar në kontratën kolektive të punës, që kanë si qëllim të mënjanojnë me pajtim një konflikt, duke bërë lëshime të dyanshme, të pranuara me vullnet të lirë nga të dyja palët.”.

Neni 6

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënësi, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim.”.

Neni 7

Në nenin 19, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Punëdhënësi, për të punësuar punëmarrësin, mund të përdorë shërbimet e zyrave shtetërore të punësimit ose të agjencive private të punësimit.”.

Neni 8

Në nenin 21 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në pikën 1, fjalët “mund të përfundohet” zëvendësohen me fjalët “mund të lidhet”.

- Në pikën 2, fjalët “quhet e përfunduar” zëvendësohen me fjalët “quhet e lidhur”.

- Në pikën 3, fjalët “e përfunduar me shkrim” zëvendësohen me fjalët “e lidhur me shkrim”.

- Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Kur kontrata e punës lidhet me gojë, punëdhënësi është i detyruar që, brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, të hartojë me shkrim dokumentin përkatës, të nënshkruar prej tij dhe punëmarrësit, ku të përfshihen sidomos elementet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni. Mos hartimi i këtij dokumenti me shkrim nuk cenon vlefshmërinë e kontratës, por sjell vetëm përgjegjësinë e punëdhënësit, sipas nenit 202 pika 2 të këtij Kodi”.

Neni 9

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

1. Punëmarrësi respekton urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit.

2. Punëmarrësi nuk është i detyruar të zbatojë urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit, që ndryshojnë kushtet e kontratës së punës. Ndryshimi i kontratës bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve.

3. Punëmarrësi nuk është i detyruar të zbatojë urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit, që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e tij.”.

Neni 10

Në nenin 27, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Shkalla e kujdesit, që duhet të tregojë punëmarrësi në punë, varet nga njohuritë teknike, të nevojshme për të kryer punën e caktuar, duke pasur parasysh aftësitë dhe cilësitë e punëmarrësit, që punëdhënësi i njihet ose duhet t’i kishte njohur. Dëmi, që lidhet në mënyrë të qenësishme me kryerjen e punës, përballohet nga punëdhënësi.”.

Neni 11

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

1. Punëmarrësi mbi 18 vjeç mund të zotohet me shkrim kundrejt punëdhënësit që, pas përfundimit të marrëdhënieve të punës, nuk do t’i bëjë atij konkurrencë në asnjë lloj mënyre, veçanërisht, nuk do të formojë një sipërmarrje konkurrencte, nuk do të punojë dhe nuk do të interesohet për të.

2. Marrëveshja për ndalimin e konkurrencës është e vlefshme vetëm nëse raportet e punës i kanë dhënë mundësinë punëmarrësit të ketë dijeni për sekretet e fabrikimit ose të veprimtarisë së punëdhënësit dhe nëse përdorimi i këtyre sekreteve mund t’i shkaktojë punëdhënësit një dëm të rëndë.

3. Punëdhënësi mund të kërkojë zbatimin e marrëveshjes për ndalimin e konkurrencës vetëm nëse i ofron punëmarrësit, gjatë periudhës së ndalimit, jo më pak se 75 për qind të pagës që ai do të merrte po të vazhdonte të punonte për punëdhënësin. Kur paga është e ndryshueshme, shpërblimi llogaritet mbi bazën e pagës mesatare të vitit të mëparshëm dhe indekskohet.”.

Neni 12

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29

1. Marrëveshja duhet të përcaktojë qartë ndalimin e konkurrencës për vendin, kohën, llojin e veprimtarisë, për të mos dëmtuar të ardhmen ekonomike të punëmarrësit. Afati i ndalimit nuk mund të jetë më shumë se një vit.

2. Gjykata mund të zvogëlojë elementet e sipërpërmendura për ndalimin e konkurrencës së tepruar, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat. Ajo mban parasysh veçanërisht nëse shpërblimi i dhënë nga punëdhënësi tejkalon minimumin e parashikuar në nenin 28.”.

Neni 13

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 30

1. Ndalimi i konkurrencës merr fund në afatin e caktuar në marrëveshje.

2. Pavarësisht nga afati i caktuar në marrëveshje, ndalimi i konkurrencës përfundon nëse vërtetohet se punëdhënësi nuk ka më asnjë interes për vazhdimin e saj.

3. Marrëveshja për ndalimin e konkurrencës nuk zbatohet kur punëdhënësi zgjidh kontratën për shkaqe të pajustificuara ose kur punëmarrësi zgjidh kontratën për një shkak të justifikuar, që lidhet me punëdhënësin.”.

Neni 14

Në nenin 31, pikat 2, 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“2. Nëse në marrëveshje është parashikuar dënimi me gjobë në rast shkeljeje të ndalimit të konkurrencës, punëmarrësi mund të vazhdojë veprimtarinë konkurruese, pasi ka paguar gjobën e caktuar, megjithatë ai duhet t’i paguajë punëdhënësit edhe diferencën ndërmjet gjobës dhe dëmit të shkaktuar.

3. Nëse në marrëveshje është parashikuar dënimi me gjobë në rast shkeljeje të ndalimit të konkurrencës, gjykata mund të pakësojë gjobën, nëse ajo është e tepruar, duke marrë parasysh rrethanat që kanë çuar në këto shkelje.

4. Punëdhënësi mund të kërkojë, kur ai e ka parashikuar shprehimisht këtë të drejtë me shkrim, përveç pagimit të gjobës dhe dëmshpërblimeve të tjera të parashikuara, edhe ndalimin e veprimtarisë konkurruese, nëse kjo masë është e justifikueshme, duke marrë parasysh interesat e cenuar ose të rrezikuar të punëdhënësit, si dhe sjelljen e punëmarrësit.”.

Neni 15

Në nenin 34, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kontrolli kryhet brenda territorit të ndërmarrjes, në prani të një punëmarrësi tjetër, të pranuar nga punëmarrësi që kontrollohet.”.

Neni 16

Neni 37 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 37

Masat disiplinore parashikohen kryesisht në kontratën kolektive të punës. Në çdo rast kontrata individuale duhet t’i referohet akteve përkatëse, lidhur me masat disiplinore.”.

Neni 17

Në nenin 40, në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Punëdhënësi duhet të vendosë sinjale të dallueshme qartë në çdo vend pune, që paraqet rrezik për jetën dhe shëndetin e punëmarrësve.”.

Neni 18

Në nenin 41, në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Klasifikimi i veprimtarisë, dokumentacioni që duhet të paraqesë punëdhënësi, si dhe procedura e dhënies së lejes nga inspektori i punës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 19

Në nenin 55, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Për gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji ndalohet transportimi i ngarkesave që vënë në rrezik shëndetin e nënës dhe të fëmijës.”.

Neni 20

Në nenin 78 bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“Kohëzgjatja ditore normale e punës është jo më shumë se 8 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave në kontratën kolektive ose në kontratën individuale të punës, brenda limiteve të kohës javore maksimale të punës.”.

- Pika 2 shfuqizohet.

Neni 21

Neni 83 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 83

Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave në kontratën kolektive ose në kontratën individuale të punës.”.

Neni 22

Në nenin 86 bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 2 fjalja e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kur dita e festës zyrtare bie në ditët e pushimit javor, pushimi shtyhet ditën e hënë.”.

- Në fund të pikës 3 shtohen fjalët “ose në kontratën kolektive”.

Neni 23

Neni 87 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 87

Puna e kryer ditën e pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompensohet me një shtesë page jo më pak se 25 për qind ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune, që merret një javë para ose pas kryerjes së saj.”.

Neni 24

Në nenin 92, në pikën 2, fjalët “jo më pak se 3 javë kalendarike” bëhen “jo më pak se 4 javë kalendarike”.

Neni 25

Në nenin 93, në fund të pikës 3, fjalët “më pak se 6 ditë rresht” bëhen “më pak se një javë kalendarike pa ndërprerje”.

Neni 26

Neni 98 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 98

1. Ndalohet marrja në punë e të miturve nën moshën 16 vjeç. Bëjnë përjashtim rastet kur të miturit nga mosha 14 deri në 16 vjeç punësohen gjatë pushimeve shkollore vetëm në punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tyre.

2. Të miturit nga mosha 14 vjeç deri në moshën 16 vjeç mund të jenë subjekt i këshillimit dhe i formimit profesional, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 27

Në nenin 99, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Të miturit nga mosha 16 deri në 18 vjeç mund të punësohen në punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tyre.”.

Neni 28

Neni 100 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 100

Vetëm personat madhorë, mbi 18 vjeç, mund të punësohen në punë të vështira ose që paraqesin rrezik për shëndetin ose personalitetin e tyre.

Punët e vështira ose të rrezikshme dhe rregullat e veçanta për kohëzgjatjen dhe kushtet e kryerjes së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 29

Neni 104 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 104

1. Ndalohet puna për gratë shtatzëna 35 ditë para lindjes dhe 42 ditë pas lindjes. Kur gruaja shtatzënë ka në barrë më shumë se një fëmijë, periudha e parë bëhet 60 ditë.

2. Gratë shtatzëna ose me fëmijë në gji nuk mund të punësohen në punë të rënda ose të rrezikshme, që dëmtojnë shëndetin e nënës dhe të fëmijës. Këshilli i Ministrave përcakton punët e rënda ose të rrezikshme, që dëmtojnë shëndetin e nënës dhe të fëmijës, si dhe rregulla të veçanta për kushtet e punës për gratë shtatzëna dhe ato me fëmijë në gji.”.

Neni 30

Në nenin 105, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Pas periudhës 42-ditore të paslindjes, gruaja vendos vetë nëse dëshiron të punojë ose të përfitojë nga sigurimet shoqërore.”.

Neni 31

Pas nenit 105 shtohet neni 105/a me këtë përmbajtje:

“Neni 105/a

Mbrojtja e punësimit të gruas

1. Ndalohen testet e shtatzanisë para punësimit, kur kërkohen nga punëdhënësi, përveç rasteve kur vendi i punës kërkon të punohet në kushte që mund të ndikojnë negativisht në shtatzaninë ose që mund të dëmtojnë jetën apo shëndetin e nënës ose të fëmijës.

2. Në rastet e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi, kur gruaja është në punë gjatë periudhës së shtatzanisë ose është kthyer në punë pas lindjes së fëmijës, sipas nenit 30 të këtij Kodi, i takon punëdhënësit të vërtetojë se shkak i pushimit nga puna nuk ka qenë shtatzania ose lindja e fëmijës.”.

Neni 32

Në pikën 2 të nenit 108 shtohen fjalët “dhe për nënat me fëmijë në gji”.

Neni 33

Në nenin 118, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Paga duhet të paguhet në monedhë shqiptare, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe nga marrëveshja ndërmjet palëve. Ajo mund të paguhet edhe me çek bankar, çek postar ose

urdhër pagese, kur kjo lloj pagese është e nevojshme për shkak të rrethanave të veçanta ose kur parashikohet në kontratën kolektive a në një vendim arbitrazhi. Kur kjo lloj pagese nuk është parashikuar ose vendosur, merret pëlqimi i punëmarrësit të interesuar. Punëdhënësi përgjigjet financiarisht ndaj punëmarrësit, kur banka nuk mund të paguajë brenda 30 ditëve nga data e derdhjes së shumës, për llogari të punëmarrësit.”.

Neni 34

Në nenin 122 bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1, fjalët “minimumin jetik” zëvendësohen me fjalët “pagën e paprekshme”.

- Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Punëdhënësi mund ta kompensojë pagën me një kredi ndaj punëmarrësit, nëse nuk preket paga e paprekshme. Detyrimet, që rrjedhin nga një dëm i shkaktuar qëllimisht, kompensohen pa asnjë kufizim.”.

- Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ndalohet dhënia e gjobave nga punëdhënësi, me përjashtim të gjobave të përcaktuara në kontratën kolektive.”.

Neni 35

Neni 123 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 123

Paga e paprekshme

1. Paga konsiderohet e paprekshme në masën që është e nevojshme për të siguruar jetesën e punëmarrësit dhe të familjes së tij.

2. Paga e paprekshme vendoset rast pas rasti nga gjykata. Në vendimin e saj, gjykata merr parasysh shpenzimet e nevojshme për ushqim, qira, veshje, si edhe detyrimet fiskale ose kontributet për sigurime shoqërore të detyrueshme të punëmarrësit dhe të familjes së tij.

3. Kur gjykata vendos që nuk ka mundësi të vlerësojë të gjitha elementet për të përcaktuar pagën e paprekshme, kjo do të jetë e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi, të caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 36

Në nenin 129, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Bëjnë përjashtim rastet e forcave madhore, si dhe rasti kur punëmarrësi shkakton vetë me faj pamundësinë e kryerjes së punës.”.

Neni 37

Në nenin 130, në pikën 1, fjalët “80 për qind të pagës” bëhen “jo më pak se 80 për qind të pagës”.

Neni 38

Në nenin 131, pas fjalëve “aksidenti në punë” shtohen “ose të një sëmundjeje profesionale”.

Neni 39

Në nenin 138, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Pushimi nga puna i punëmarrësit nga punëdhënësi, për arsye të transferimit të ndërmarrjes, është i pavlefshëm. Bëjnë përjashtim pushimet që ndodhin për arsye ekonomike, teknologjike ose strukturore, që kërkojnë ndryshime në planin e punësimit. Në këtë rast, pushimet duhet të respektojnë

rregullat e përcaktuara në kreun XIV."

Neni 40

Në nenin 139 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"Kur në mosrespektim të këtyre procedurave punëdhënësi ka zgjidhur kontratën në dëm të punëmarrësit, ky i fundit, përveç pagës që duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit, ka të drejtën e një dëmshpërblimi deri në gjashtë paga mujore."

Neni 41

Në nenin 140, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Si rregull, kontrata e punës lidhet për një periudhë të pacaktuar. Lidhja e kontratës së punës për një periudhë të caktuar duhet të justifikohet me arsye objektive, që lidhen me natyrën e përkohshme të detyrës, në të cilën punëmarrësi do të punësohet. Nëse kohëzgjatja nuk përcaktohet me saktësi nga palët gjatë lidhjes së kontratës, ajo trajtohet si kontratë me periudhë të pacaktuar."

Neni 42

Në nenin 143 bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Pas kohës së marrjes në provë, për të zgjidhur kontratën me periudhë të pacaktuar, palët duhet të respektojnë një afat njoftimi prej një muaji, gjatë vitit të parë të punës, prej dy muajsh për dy deri në pesë vjet pune, prej tre muajsh për më shumë se pesë vjet pune."

- Në pikën 2, në fjalinë e dytë, fjalët "një javë deri në gjashtë muaj" bëhen "deri në gjashtë muaj".

- Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës zgjatet, sipas rastit, deri në fund të javës ose deri në fund të muajit. Zbatohet i njëjti rregull kur afati i njoftimit pezullohet gjatë periudhës së paaftësisë për punë, shtatzanisë ose pushimeve të dhëna nga punëdhënësi."

Neni 43

Në nenin 144 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- Titulli i nenit ndryshohet "Procedura e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi".

- Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit."

- Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Kjo procedurë zbatohet edhe në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës."

- Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Punëdhënësi, që nuk respekton procedurën e përcaktuar në këtë nen, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim prej dy muajsh pagë, që i shtohet dëmshpërblimeve të tjera të mundshme. Zgjidhja e kontratës në kundërshtim me këtë dispozitë mbetet e vlefshme."

- Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

"5/1. I takon punëdhënësit të vërtetojë që procedura e përcaktuar nga ky nen është respektuar."

Neni 44

Në nenin 146 bëhen këto ndryshime:

- Në shkronjën "c" të pikës 1, fjalët "për motive, të cilat lidhen me personalitetin e punëmarrësit" zëvendësohen me fjalët "për motive të pandashme nga personaliteti i punëmarrësit".

- Shkronjat "f" dhe "g" të kësaj pike shfuqizohen.

- Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme. Punëdhënësi që ka zgjidhur kontratën pa shkaqe të arsyeshme, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim gjykate të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim."

Neni 45

Neni 147 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 147

1. Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën në kohën kur, sipas legjislacionit në fuqi, punëmarrësi kryen shërbimin ushtarak, përfiton pagesë paaftësie të përkohshme në punë nga punëdhënësi ose sigurimet shoqërore, për një periudhë deri në një vit, si dhe kur punëmarrësi është me pushime të dhëna nga punëdhënësi.

2. Kur zgjidhja e kontratës bëhet para se punëmarrësi të thirret në shërbimin ushtarak, të jetë me paaftësi të përkohshme në punë ose të jetë me pushime të dhëna nga punëdhënësi dhe afati i njoftimit nuk ka përfunduar, ky afat pezullohet për periudhën e kryerjes së shërbimit ushtarak, të paaftësisë së përkohshme në punë ose të pushimeve të dhëna nga punëdhënësi dhe rifillon pas përfundimit të kësaj periudhe."

Neni 46

Neni 148 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 148

1. Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është të paktën 10 për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës; 15 për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës; 20 për ndërmarrjet me mbi 200 deri në 300 punonjës dhe 30 për ndërmarrjet me mbi 300 punonjës.

2. Kur punëdhënësi parashikon të bëjë pushime kolektive nga puna, ai duhet të njoftojë me shkrim organizatën e punëmarrësve, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve. Në mungesë të saj, punëdhënësi njofton punëmarrësit e tij nëpërmjet afishimit në mënyrë të dukshme, në vendin e punës. Njoftimi duhet të përmbajë veçanërisht arsyet e pushimit nga puna, numrin e punëmarrësve që do të pushohen, numrin e punëmarrësve të punësuar normalisht, si dhe kohën gjatë së cilës është parashikuar të kryhen këto pushime. Punëdhënësi i dorëzon Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale një kopje të këtij njoftimi.

3. Punëdhënësi bën këshillime me organizatën e punëmarrësve, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në mungesë të saj, punëdhënësi u jep mundësi punëmarrësve të marrin pjesë në këshillime. Ato bëhen për marrjen e masave për të shmangur ose pakësuar pushimet kolektive nga puna dhe për të zbutur pasojat e tyre. Këshillimet bëhen brenda 20 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit, e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, përveç kur punëdhënësi pranon një kohëzgjatje më të madhe.

4. Punëdhënësi njofton me shkrim Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale për përfundimin e këshillimeve. Ai i dërgon një kopje të këtij njoftimi palës së interesuar. Nëse palët nuk kanë rënë dakord, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale i ndihmon ato të arrijnë një marrëveshje, brenda 20 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit, e parashikuar në këtë pikë, përveç kur punëdhënësi pranon një kohëzgjatje më të madhe. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale nuk mund t'i ndalojë pushimet kolektive.

5. Pas përfundimit të afatit njëzetditor, të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, punëdhënësi njofton punëmarrësit që do të pushohen, si dhe për zgjidhjen e kontratës, duke respektuar afatet e njoftimit të parashikuara në nenin 143.

6. Punëdhënësi, që nuk respekton procedurën e pushimit kolektiv nga puna, të parashikuar në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në gjashtë muaj pagë dëmshpërblim, i cili i shtohet pagës gjatë afatit të njoftimit ose dëmshpërblimit që merret në rast mosrespektimi të këtij afati, të parashikuar në nenin 143.

7. Punëdhënësi duhet t'u japë përparësi në rimarrjen në punë punëmarrësve të pushuar nga puna për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësit, nëse ai punëson punëmarrës me kualifikim të krahasueshëm."

Neni 47

Në nenin 150, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Palët parashikojnë me shkrim një periudhë prove jo më shumë se tre muaj. Nuk mund të parashikohet periudhë prove, kur ndërmjet palëve ka qenë lidhur një kontratë pune, e cila kishte si objekt kryerjen e së njëjtës punë."

Neni 48

Neni 151 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 151

1. Kur ndërmjet palëve kanë qenë lidhur disa kontrata të njëpasnjëshme me afat të caktuar, për jo më pak se tre vjet, mosripërtëritja e kontratës së fundit nga punëdhënësi vlerësohet si zgjidhje e kontratës me afat të pacaktuar.

2. Kur kontrata lidhet për më shumë se 3 deri në 5 vjet, ajo mund të zgjidhet nga punëmarrësi pas 3 vjetësh. Në këtë rast afati i njoftimit është 2 muaj dhe zgjatet deri në fund të muajit të dytë. Kur kontrata lidhet për më shumë se 5 vjet, ajo mund të zgjidhet nga punëmarrësi pas 5 vjetësh. Në këtë rast afati i njoftimit është 3 muaj dhe zgjatet deri në fund të muajit të tretë."

Neni 49

Neni 153 ndryshohet si më poshtë:

"C. ZGJIDHJA E MENJËHERSHME E KONTRATËS

Neni 153

Shkaqe të justifikuara

1. Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara.

2. Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t'i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

3. Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit."

Neni 50

Në nenin 154 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Kur shkaqet e justifikuara të zgjidhjes së kontratës me efekt të menjëhershëm lidhen me mosrespektimin e kontratës nga njëra palë, ajo duhet të ndreqë tërësisht dëmin e shkaktuar palës tjetër, si rrjedhim i mosrespektimit të afatit të njoftimit."

- Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Gjykata, në rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, vendos që punëdhësi të mos paguajë dëmshpërblimin e parashikuar në nenin 144 pika 5."

- Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Punëmarrësi i pushuar nga puna në mënyrë të menjëhershme e të justifikuar humbet të drejtën e shpërblimit për vjetërsi, por ruan të drejtën e shpërblimit për pushimet e pamarra. Çdo pretendim tjetër që buron nga marrëdhëniet e punës mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor."

Neni 51

Në nenin 155, në fund të pikës 3 shtohet kjo fjali:

"Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim."

Neni 52

Në nenin 157, në pikën 2, fjalët " për më shumë se 5 vjet" bëhen "për më shumë se 3 vjet".

Neni 53

Në nenin 163 shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

"3. Punëdhënësi, të cilit i është kërkuar fillimi i bisedimeve, duhet ta bëjë kërkesën publike, duke e afishuar në mënyrë të dukshme gjatë dy javëve në ndërmarrje. Nëse kërkesa është bërë në nivel dege, ajo duhet të afishohet në të gjitha ndërmarrjet ose degët. Organizata ose organizatat e punëmarrësve, që kërkojnë fillimin e bisedimeve, duhet të kujdesen që afishimi të kryhet në mënyrë të rregullt.

4. Nëse përfaqësueshmëria e organizatës ose e organizatave të punëmarrësve, që kërkojnë fillimin e bisedimeve, nuk është kundërshtuar, veprohet sipas nenit 165. Në këtë rast, përfaqësueshmëria e organizatës ose organizatave të punëmarrësve nuk mund të kundërshtohet gjatë dy vjetëve.

5. Nëse lidhja e kontratës kolektive nuk është paraprirë nga një afishim i rregullt i kërkesës, punëdhënësit ose organizata e punëdhënësve nuk mund të kundërshtojnë fillimin e një procedure të re të njohjes së përfaqësueshmërisë së organizatës ose organizatave të punëmarrësve, me qëllim hapjen e bisedimeve për lidhjen e një kontrate tjetër kolektive. Kontrata e parë kolektive, e lidhur pa respektuar detyrimin e afishimit, është e pavlefshme që nga çasti i hyrjes në fuqi të kontratës së dytë, që është lidhur duke respektuar procedurat e parashikuara në këtë Kod."

Neni 54

Neni 164 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 164

1. Nëse përfaqësueshmëria e organizatës ose organizatave të punëmarrësve, që kanë kërkuar fillimin e bisedimeve kundërshtohet, çdo organizatë e punëmarrësve e interesuar duhet t'i dorëzojë punëdhënësit ose organizatës së punëdhënësve, me shpenzimet e veta, provën e përfaqësueshmërisë. Kjo provë paraqitet në formën e një vërtetimi noterial, ku noteri vërteton numrin e anëtarëve të organizatës së punëmarrësve, në bazë të kuotizacioneve të paguara gjatë dy vjetëve të fundit ose deklarimeve, me shkrim ose me gojë, të punëmarrësve anëtarë.

2. Organizata që provon se ka numrin më të madh të anëtarëve punëmarrës në ndërmarrje ose degë, vlerësohet si organizata më e përfaqësuar. Nëse disa organizata punëmarrësish paraqiten së bashku, vlerësohet më i përfaqësuar grupi i organizatave që ka numrin më të madh të anëtarëve.

3. Nëse punëdhënësi, organizata e punëdhënësve ose organizatat e punëmarrësve kundërshtojnë vërtetimin noterial, ata duhet të dorëzojnë një ankim në zyrën e pajtimit të qarkut (nëse bisedimet për kontratën kolektive nuk kalojnë kufijtë e një qarku), ose në Zyrën Kombëtare të Pajtimit (nëse bisedimet për kontratën kolektive shtrihen në më shumë se një qark). Ky ankim duhet dorëzuar

brenda dy javëve, duke filluar nga data e shpalljes së rezultatit sipas vërtetimit noterial. Zyra e pajtimit shqyrton të gjitha provat dhe vendos për përfaqësueshmërinë e organizatës ose organizatave të punëmarrësve dhe e shpall atë brenda dy javëve nga data e vënies së saj në lëvizje. Kur punëdhënësi ose organizata e punëdhënësve nuk e pranojnë vendimin e zyrës së pajtimit, ata kanë të drejtë të kërkojnë organizimin e një votimi të fshehtë brenda dy javëve nga data e shpalljes së vendimit.

Mënyra e organizimit dhe procedura e votimit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Përfaqësueshmëria e organizatës ose organizatave të punëmarrësve nuk mund të kundërshtohet gjatë dy vjetëve, duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga zyra e pajtimit, të pranuar nga palët, ose të rezultatit nga komisioni i votimit.”.

Pika 5 shfuqizohet.

Neni 55

Neni 165 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 165

1. Kur përfaqësueshmëria e organizatës ose organizatave të punëmarrësve nuk është kundërshtuar ose kur ajo është njohur në mënyrë përfundimtare, punëdhënësi ose organizata e punëdhënësve duhet të presin palën kërkuese të bisedimeve brenda dy javëve, duke filluar nga data e përfundimit të afatit të afishimit ose, në rast kundërshtimi të përfaqësueshmërisë, duke filluar nga data e shpalljes përfundimtare të saj.

2. Nëse bisedimet nuk përfundojnë brenda 30 ditëve, duke filluar nga data e përfundimit të afatit të afishimit ose në rast kundërshtimi të përfaqësueshmërisë, duke filluar nga data e shpalljes përfundimtare të saj, asnjëra nga palët nuk mund të përdorë të drejtën e grevës, pa vënë më parë në lëvizje ndërmjetësin, zyrën e pajtimit, si dhe, nëse palët bien dakord, Gjykatën e Arbitrazhit, sipas procedurave të parashikuara në kreun XVII të këtij Kodi.”.

Pika 3 shfuqizohet.

Neni 56

Në nenin 170 bëhen këto ndryshime:

- Në pikat 1 dhe 2, fjalët "zyra e pajtimit" zëvendësohen me fjalët "Gjykata e Arbitrazhit".

- Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Përveç dëshmipërblimit të përcaktuar në pikën e mësipërme, gjykata vendos për masën e gjobës, që duhet të paguajë pala fajtores në dobi të palës së dëmtuar, në rastet kur kjo masë nuk përcaktohet në kontratën kolektive.”.

Neni 57

Në nenin 176, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

"1. Sindikatat dhe organizatat e punëdhënësve janë organizata profesionale. Organizatat profesionale të punëmarrësve dhe të punëdhënësve janë organizata shoqërore, të pavarura, që krijohen si bashkime vullnetare të punëmarrësve ose punëdhënësve, qëllimi i të cilave është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomikë, profesionalë dhe shoqërorë të anëtarëve të tyre.

2. Organizatat e punëmarrësve dhe të punëdhënësve kanë të drejtë të krijojnë federata e konfederata dhe të anëtarësohen në to. Federata krijohet nga bashkimi vullnetar i dy ose më shumë organizatave profesionale. Konfederata krijohet nga bashkimi vullnetar i dy ose më shumë federatave. Çdo organizatë, federatë ose konfederatë ka të drejtë të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare punëmarrësish ose punëdhënësish.”.

Neni 58

Në nenin 177, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Akti i krijimit dhe statuti i çdo organizate profesionale duhet të nënshkruhen nga jo më pak se 5 anëtarë themelues për organizatën e punëdhënësve dhe jo më pak se 20 anëtarë themelues për organizatën e punëmarrësve."

Neni 59

Në nenin 178, në pikën 1, përpara fjalës "statutin" shtohen fjalët "aktin e krijimit dhe".

Neni 60

Në nenin 181 shtohen pikat 4, 5, 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

"4. Zgjidhja nga punëdhënësi e kontratës së punës për përfaqësuesit e organizatës së punëmarrësve, pa pëlqimin e kësaj organizate, është e pavlefshme, me përjashtim të rasteve kur punëmarrësi shkel ligjin, kontratën kolektive të punës, kontratën individuale të punës ose nëse punëdhënësi provon që zgjidhja e kontratës është e domosdoshme për veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjes.

5. Ndryshimi i kushteve të kontratës së punës të përfaqësuesve të organizatës së punëmarrësve mund të bëhet vetëm me pëlqimin e punëmarrësit dhe të kësaj organizate. Punëdhënësi nuk mund të ndryshojë vendin e punës së përfaqësuesve të organizatës së punëmarrësve, edhe nëse ky ndryshim është parashikuar nga kontrata e punës, pa pëlqimin e punëmarrësit dhe të kësaj organizate, me përjashtim të rasteve kur ndryshimi është i domosdoshëm për veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjes.

6. Nëse përfaqësuesit e organizatave të punëmarrësve, që veprojnë në shkallë kombëtare, gjatë mandatit të tyre punojnë dhe paguhen nga këto organizata, kontrata e tyre e punës me punëdhënësin pezullohet. Në përfundim të mandatit pezullimi mbaron dhe kontrata e punës rihyn në fuqi. Që nga ky çast, palët kanë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kontrata e punës.

7. Punëdhënësi duhet të krijojë kushte dhe lehtësitë e nevojshme për përfaqësuesit e zgjedhur të organizatave të punëmarrësve për ushtrimin normalisht të funksioneve të tyre, të cilat përcaktohen në kontratën kolektive të punës. Për këtë qëllim punëdhënësi duhet:

- a) të lejojë hyrjen e tyre në mjediset e punës;
- b) të lejojë shpërndarjen e njoftimeve, broshurave, publikimeve dhe dokumenteve të tjera të organizatës së punëmarrësve;
- c) t'u japë kohën e nevojshme për të marrë pjesë në veprimtaritë e këtyre organizatave brenda dhe jashtë vendit;
- ç) të lejojë dhe t'u krijojë lehtësi në mjediset e punës për grumbullimin e kuotizacioneve të organizatës, si dhe për organizimin e mbledhjeve dhe të takimeve."

Neni 61

Neni 184 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 184

1. Ndalohej çdo akt ndërhyrjeje në krijimin, funksionimin ose administrimin e organizatave profesionale nga organet shtetërore.

2. Ndalohej çdo akt ndërhyrjeje në krijimin, funksionimin ose administrimin e organizatave të punëmarrësve nga punëdhënësit ose organizatat e punëdhënësve."

Neni 62

Në nenin 187, në fund të pikës 2 shtohen fjalët "dhe nëse asnjë lloj mase tjetër nuk mund të ndalojë organizatën të kryejë këtë veprimtari."

Neni 63

Titulli i Kreut VII "KONFLIKTET KOLEKTIVE" zëvendësohet me "NDËRMJETËSIMI, PAJTIMI, ARBITRIMI".

Neni 64

Pas nenit 188 shtohet neni 188/a me këtë përmbajtje:
"NDËRMJETËSI

Neni 188/a

Ndërmjetësi caktohet nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale ose organi administrativ i autorizuar prej tij brenda administratës publike të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale."

Neni 65

Në nenin 189 bëhen këto ndryshime:

Titulli bëhet "ZYRA SHITETËRORE E PAJTIMIT".

Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Në çdo qark krijohet zyra e pajtimit. Zyra e pajtimit ngrihet me urdhër të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale."

- Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Zyra e pajtimit përbëhet nga kryetari dhe 2 anëtarë, përfaqësues të organizatave më të përfaqësuara të punëmarrësve dhe 2 anëtarë, përfaqësues të organizatave më të përfaqësuara të punëdhënësve."

-Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Kryetari dhe anëtarët paguhën nga shteti në masën e caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave."

- Pika 4 bëhet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Procedura e pajtimit është falas dhe rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 66

Neni 190 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 190

1. Zyra e pajtimit në qark është përgjegjëse për zgjidhjen e çdo konflikti që lind brenda qarkut, ku ajo ndodhet.

2. Zyra Kombëtare e Pajtimit është përgjegjëse për zgjidhjen e çdo konflikti që prek më shumë se një qark.

3. Kur rrethanat e justifikojnë, Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale mund të vërë në lëvizje Zyrën Kombëtare të Pajtimit për çdo konflikt që lind brenda një qarku.

4. Zyra Kombëtare e Pajtimit mund të vendosë të mbledhet edhe jashtë Tiranës."

Neni 67

Neni 191 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 191

1. Ndërmjetësi dhe zyra e pajtimit mund të vihen në lëvizje për çdo konflikt kolektiv. Ata mund të deklarohen jopërgjegjës nëse palët janë të lidhura me një kontratë kolektive në fuqi, e cila parashikon një procedurë pajtimi të mjaftueshme.

2. Konfliktet që lidhen me interpretimin ose zbatimin e ligjit, në parim, shqyrtohen nga gjykata ose Gjykata e Arbitrazhit. Nëse ndërmjetësi ose zyra e pajtimit janë vënë në lëvizje, ata mund

të heqin dorë nga procedura e ndërmjetësimit. Çdo palë ruan të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës ose Gjykatës së Arbitrazhit.

3. Kur rrethanat e justifikojnë, kryetari mund të pranojë që zyra e pajtimit të vihet në lëvizje në një konflikt ndërmjet dy a më shumë organizatave punëmarrësish dhe ndërmjet dy a më shumë organizatave punëdhënësish."

Neni 68

Neni 192 ndryshohet si më poshtë:
"PROCEDURA

Neni 192
Ndërmjetësi

1. Ndërmjetësi angazhohet për çdo konflikt kolektiv me kërkesën e çdo pale të interesuar te Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale ose tek Inspektorati Shtetëror i Punës.

2. Ndërmjetësi, kur angazhohet në një konflikt kolektiv, duhet të ndërhyjë pa vonesë për të ndihmuar palët për të gjetur një zgjidhje me mirëkuptim.

3. Procedura e ndërmjetësimit është e detyrueshme dhe zgjat deri në 10 ditë."

Neni 69

Neni 193 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 193
Zyra e pajtimit

1. Në rast dështimi të ndërmjetësit, Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale ose organi administrativ i autorizuar prej tij, vë në lëvizje zyrën e pajtimit.

2. Zyra mund të thërrasë çdo palë të interesuar. Palët kanë detyrimin të paraqiten në seancën e shqyrtimit dhe të marrin pjesë në debate, duke paraqitur të dhënat që kërkon zyra.

3. Me kërkesën e arsyetuar të njëres prej palëve, vetëm kryetari merr të dhëna për dokumentet e paraqitura nga kjo palë. Më pas ai ua njofton ato, për aq sa e gjykon të arsyeshme, anëtarëve të zyrës së pajtimit.

4. Zyra e pajtimit përpaket të ndihmojë pajtimin e palëve.

5. Zyra e pajtimit i paraqet palëve një propozim pajtimi, të cilin ajo mund të vendosë që ta bëjë publik.

6. Palët mund të ndihmohen nga çdo person i caktuar prej tyre.

7. Procedura e pajtimit është e detyrueshme dhe zgjat deri në 20 ditë.

8. Rregullat e tjera procedurale caktohen nga kryetari i zyrës së pajtimit."

Neni 70

Neni 194 ndryshohet si më poshtë:
"GJYKATA E ARBITRAZHIT

Neni 194

1. Në rast dështimi të pajtimit, të dyja palët munden, së bashku, t'i drejtohen Gjykatës së Arbitrazhit. Palët zgjedhin me marrëveshje, në mënyrë të lirë, një ose tre arbitra. Për të ndihmuar dhe këshilluar palët, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale u ofron një listë arbitrash.

2. Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit është titull ekzekutiv, në bazë të rregullave mbi arbitrimin, të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

3. Arbitrat paguhen nga palët.

4. Arbitrimi duhet të përfundojë brenda 3 javëve, duke filluar nga data e vënies në lëvizje të

Gjykatës së Arbitrazhit."

Neni 71

Neni 195 ndryshohet si më poshtë:

"REGJIME TË VEÇANTA TË PARASHIKUARA ME NJË KONTRATË KOLEKTIVE

Neni 195

1. Palët me një kontratë kolektive mund të caktojnë një ndërmjetës, një zyrë pajtimi ose një gjykatë arbitrazhi për të zgjidhur mosmarrëveshjet.

2. Në këtë rast, ndërmjetësi dhe zyra shtetërore e pajtimit, të parashikuar nga ky Kod, nuk janë përgjegjës për zgjidhjen e konfliktit. Përfshihen rastet kur ndërmjetësi dhe zyra e pajtimit, të parashikuar në marrëveshje, nuk janë në gjendje të vihen në lëvizje në kohën e duhur."

Neni 72

Neni 196 ndryshohet si më poshtë:

"ARBITRIMI NË SHËRBIMET ME RËNDËSI JETIKE

Neni 196

Në shërbimet me rëndësi jetike, të përcaktuara nga ky Kod, konfliktet zgjidhen në mënyrë të detyrueshme dhe përfundimtare, pas procedurës së ndërmjetësimit dhe pajtimit, nga një gjykatë arbitrazhi e përbërë nga tre arbitra të zgjedhur nga palët. Në rast se palët nuk bien dakord, arbitrat caktohen nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale brenda pesë ditëve, duke filluar nga data e kërkesës së njërës prej palëve.

Neni 73

Neni 197 ndryshohet si më poshtë:

"E DREJTA E GREVËS

TË PËRGJITHSHME

Neni 197

1. E drejta e grevës garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

2. Sindikatat kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e grevës për zgjidhjen e kërkesave të tyre ekonomike dhe shoqërore, në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod.

3. Pjesëmarrja në grevë është vullnetare. Askush nuk mund të detyrohet të marrë pjesë në një grevë kundër dëshirës së vet.

4. Ndalohet çdo veprim që përfshin shtrëngim, cenim ose diskriminim ndaj punëmarrësve, për shkak të pjesëmarrjes ose jo në grevë.

5. Gjatë zhvillimit të grevës, palët duhet të bëjnë përpjekje, nëpërmjet bisedimeve, për arritjen e mirëkuptimit dhe nënshkrimin e marrëveshjes."

Neni 74

Pas nenit 197 shtohen nenet si më poshtë:

"Subjekti i të drejtës së grevës

Neni 197/1

Vetëm sindikatat kanë të drejtë të organizojnë grevën dhe ta shpallin atë.

Mbrojtja e të drejtës për punë dhe e të drejtës për grevë

Neni 197/2

1. Nuk lejohet përdorimi i forcës për ndërprerjen e grevës së ligjshme të punonjësve.
2. Organizatat e punëmarrësve mund të ndërmarrin veprime me mjete paqësore, që të bindin punonjësit, për të marrë pjesë në grevë, pa shkelur të drejtën për të punuar të punonjësve që nuk marrin pjesë në të.
3. Punëdhënësi ndalohet që gjatë zhvillimit të grevës të zëvendësojë në punë grevistët me persona të tjerë, të cilët në kohën e shpalljes së grevës nuk kanë qenë punonjës të tij, si dhe nuk lejohet të marrë punonjës të rinj pas kësaj date.

LIGJSHMËRIA E GREVËS

Neni 197/3

Kushtet e përgjithshme

Greva është e ligjshme kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

1. Organizohet nga një sindikatë, që gëzon personalitet juridik ose aderon në një organizatë punëmarrësish me personalitet të tillë.
2. Ka për qëllim të arrijë nënshkrimin e një kontrate kolektive pune ose, nëse ekziston një e tillë, plotësimin e kërkesave që burojnë nga marrëdhëniet e punës dhe që nuk rregullohen nga kjo kontratë, përveç rasteve kur kjo e fundit parashikon detyrimin tërësor të pagës, të parashikuar në nenin 169 pika 2.
3. Sindikata ose sindikatat, nga njëra anë, dhe organizata ose organizatat e punëdhënësve, nga ana tjetër, janë përpjekur të bien dakord, duke iu nënshtruar procedurës së ndërmjetësimit dhe pajtimit.
4. Nuk është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Gjendjet e veçanta

Neni 197/4

1. Greva nuk mund të ushtrohet ose, kur ka filluar, të pezullohet në gjendje të veçanta, për aq kohë sa vazhdon kjo gjendje.
2. Janë gjendje të veçanta:
 - a) fatkeqësitë natyrore;
 - b) gjendja e luftës;
 - c) gjendja e jashtëzakonshme;
 - ç) rastet kur vihet në rrezik liria e zgjedhjeve.

Shërbimet e rëndësishë jetike

Neni 197/5

1. Greva nuk mund të ushtrohet në shërbimet e rëndësishë jetike, ku ndërprerja e punës rrezikon jetën, sigurinë personale ose shëndetin e një pjese ose të tërë popullsisë. Në këtë rast, konfliktet kolektive zgjidhen në mënyrë përfundimtare dhe të detyrueshme, sipas nenit 196 të këtij Kodi.
2. Janë shërbime të rëndësishë jetike:
 - a) shërbimet e domosdoshme mjekësore dhe spitalore;
 - b) shërbimet e furnizimit me ujë;
 - c) shërbimet e furnizimit me energji elektrike;
 - ç) shërbimet e kontrollit të trafikut ajror;
 - d) shërbimet e mbrojtjes kundër zjarrit;
 - dh) shërbimet në burgje.

Shërbimet minimale

Neni 197/6

1. Greva nuk mund të ushtrohet nëse nuk sigurohet kryerja e shërbimit minimal.
2. Shërbimet minimale mund të kërkojnë në sektorët e shërbimeve, për plotësimin e nevojave të rëndësishme themelore të popullsisë, me qëllim që asaj t'i sigurohet plotësimi i këtyre nevojave.
3. Për plotësimin e shërbimeve minimale, sindikatat duhet të përcaktojnë dhe të sigurojnë, gjatë zhvillimit të grevës, punonjësit e nevojshëm për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e makinerive dhe të pajisjeve.
4. Punonjësit e përmendur në pikën 3 caktohen me marrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe sindikatës ose sindikatave përkatëse të punëmarrësve. Kur palët nuk arrijnë të merren vesh për numrin dhe detyrat e punonjësve përkatës për sigurimin e shërbimeve minimale, mosmarrëveshja zgjidhet detyrimisht dhe përfundimisht nga një arbitër i caktuar nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale ose organi administrativ i autorizuar prej tij, në këshillim me palët. Arbitri duhet të vendosë brenda 24 orëve nga çasti i caktimit të tij.

Greva e solidaritetit

Neni 197/7

Greva e solidaritetit është e ligjshme nëse ajo mbështet një grevë të ligjshme kundër një punëdhënësi, në ndihmë të të cilit punëdhënësi i grevistëve solidarë jep mbështetje aktive për të ndaluar ose përfunduar grevën.

EFEKTET E GREVËS

Neni 197/8

Efektet e grevës së ligjshme

1. Gjatë zhvillimit të grevës pezullohen detyrimet dhe të drejtat, që rrjedhin nga kontrata e punës, duke përfshirë të drejtën e pagës dhe detyrimin e bindjes në punë.
 2. Dispozitat e pikës 1 nuk prekin të drejtat e parashikuara me ligj për përkujdesin shoqëror, aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale.
 3. Periudha e pezullimit nuk prek vjetërsinë në punë dhe efektet e saj.
 4. Pushimi nga puna për shkak të një greve të ligjshme është i pavlefshëm.
- Kjo dispozitë nuk zbatohet kur punëmarrësi, gjatë grevës, kryen një akt që bie në kundërshtim me ligjin.

Neni 197/9

Efektet e grevës së paligjshme

1. Kur greva nuk është e ligjshme, punëdhënësi mund të ndërpresë marrëdhëniet e punës me grevistët. Ai ka të drejtë që ndaj punëmarrësve që nuk rifillojnë punën brenda tre ditëve, të zgjidhë kontratën e punës me efekt të menjëhershëm, si dhe t'u kërkojë atyre shlyerjen e dëmit të shkaktuar. Në këtë rast nuk zbatohen dispozitat për procedurat e pushimit nga puna.
2. Kërkesa për dëmshpërblim mund të drejtohet edhe kundër sindikatës që organizon grevën.
3. Kur greva shoqërohet me veprime të paligjshme, palët i drejtohen gjykatës, e cila përcakton përgjegjësitë e palëve, veprimet që ato duhet të kryejnë, cakton dëmin e shkaktuar dhe detyrimet e palës që duhet të zhdëmtojë.
4. Nëse rrethanat e lejojnë, gjykata mund të vendosë rifillimin e punës.

Përfundimi i grevës

Neni 197/10

Greva përfundon kur palët arrijnë një marrëveshje ose kur sindikata, që e ka shpallur atë, vendos ndërprerjen e saj."

Neni 75

Në nenin 200 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“Konsultimet bëhen veçanërisht lidhur me përgatitjet dhe zbatimin e legjislacionit të punës, ndryshimet e këtij Kodi dhe përmbajtjen e akteve nënligjore, me politikën dhe organizmat kombëtarë që kanë të bëjnë me punësimin, formimin profesional, mbrojtjen e punëmarrësve, higjienën dhe sigurimin teknik, prodhimin, mirëqenien, programet e zhvillimit ekonomik e shoqëror, si dhe me zbatimin e normave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.”.

- Pikat 4, 5, 6 dhe 7 ndryshohen si më poshtë:

"4. Këshilli Kombëtar i Punës përbëhet nga 27 anëtarë dhe 27 kandidatë, nga 10 përfaqësues anëtarë dhe 10 përfaqësues kandidatë nga organizatat e punëdhënësve, nga 10 përfaqësues anëtarë dhe 10 përfaqësues kandidatë nga organizatat e punëmarrësve dhe nga 7 përfaqësues anëtarë dhe 7 përfaqësues kandidatë të Këshillit të Ministrave. Përfaqësuesit kandidatë marrin pjesë në seancat e këshillit, në mungesë të përfaqësuesve anëtarë.

5. Në këtë Këshill marrin pjesë organizatat më të përfaqësuara të punëmarrësve dhe të punëdhënësve, që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave çdo 3 vjet.

6. Këshilli i Ministrave cakton komisione të specializuara tripalëshe, të përhershme, në këshillim edhe me partnerët socialë.

7. Emërimi i anëtarëve dhe i kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës, përfaqësues të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve, bëhet nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, sipas propozimeve të këtyre organizatave, në përputhje me pikën 5 të këtij neni.”.

- Shtohen pikat 8, 9 dhe 10 me këtë përmbajtje:

"8. Këshilli Kombëtar i Punës mund të krijojë komisione të specializuara ose grupe pune të përkohshme për këshillimin dhe studimin e çështjeve të veçanta me interes të përbashkët.

9. Këshilli Kombëtar i Punës ka buxhetin e vet të pavarur, që caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Punës rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 76

Në nenin 202 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në pikën 1 shtohen fjalët “neni 181 pikat 3, 5 dhe 7 shkronjat “a”, “b” dhe “c””.

- Në pikën 2, fjalët “neni 78 pikat 2, 3 dhe 4” bëhen “neni 78 pikat 1, 2 dhe 3”; fjalët “neni 83 pika 2” bëhen “neni 83”; fjalët “neni 148 pikat 2 deri 6” bëhen “neni 148 pika 7”; fjalët “neni 165 pikat 1 dhe 2” bëhen “neni 165 pika 1”; si dhe shtohen fjalët “nenet 99 pika 1, 105/a, 193 pika 2, 197/2 pika 3.”.

- Në pikën 3 shtohet neni “50”.

- Pika 4 shfuqizohet.

- Në pikën 5 fjalët "50-fishi i gjobës maksimale" bëhen "5-fishi i gjobës maksimale".

Neni 77

Në të gjithë Kodin, fjalët "Ministri i Punës" dhe "Ministria e Punës" bëhen "Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale ose ministri përgjegjës" dhe "Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale ose ministria përgjegjëse”.

Neni 78

Neni 198 i ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", dekreti nr.7458, datë 22.1.1991, miratuar me ligjin nr.7494, datë 2.7.1991 "Për të drejtën e grevës", si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 79

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3928, datë 14.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9126, datë 29.7.2003

PËR PËRDORIMIN CIVIL TË LËNDËVE PLASËSE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i procedurave, rregullave dhe i përgjegjësi të administratës shtetërore për prodhimin, magazinimin, përdorimin, kontrollin, asgjësimin, transferimin dhe mënyrën e tregtimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, për mbrojtjen dhe sigurimin e jetës, të shëndetit të njerëzve, kafshëve, vlerave materiale dhe mjedisit nga rreziqet, që mund të shkaktojnë këto lëndë.

Neni 2

Fusha e zbatimit të ligjit

1. Ky ligj zbatohet nga të gjithë personat fizikë ose juridikë, që merren me prodhimin, magazinimin, transferimin, importimin, tregtimin dhe përdorimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, të pajisur me leje ose autorizim për ushtrimin e veprimtarisë me lëndë plasëse.

2. Ky ligj nuk zbatohet për lëndët plasëse, që përdoren nga Forcat e Armatosura dhe ato të Rendit Publik, përdorimi i të cilave rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Administrim lëndësh plasëse" është prodhimi, ambalazhimi, magazinimi, shpërndarja, transferimi, tregtimi, përdorimi dhe asgjësimi i lëndëve plasëse për përdorim civil, në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullat tekniko-administrative të këtij ligji.

2. "Lëndë plasëse" janë të gjitha ato bashkime ose përzierje të ndryshme kimike, të cilat, pa praninë e oksigjenit, nën ndikimin e ngacmimeve të jashtme, pësojnë ndryshime shumë të shpejta fiziko-kimike, të shoqëruara me temperaturë të lartë dhe çlirim gazrash në sasi e presion të lartë, të afta për të kryer punë, të cilat plotësojnë standardet e përdorimit në veprimtari civile. Lëndë plasëse për përdorim civil janë dinamitet, amonitet dhe çdo lloj lënde tjetër, që kanë të njëjtën rrezikshmëri.

3. "Materiale plasëse" janë të gjitha llojet e kapsollave, të fitilave plasës, ndezës e zjarrpërcjellës, si dhe shpërthyesit në ngarkesat e përforimit.

4. "Parti lëndësh plasëse" është një sasi e caktuar lëndësh plasëse (në copë, në vëllim ose në masë), prodhuar në kushte tërësisht të barabarta, shoqëruar me specifikime teknike.

5. "Sigurim" është tërësia e rregullave dhe e masave me karakter teknik për shmangien e rreziqeve, që vijnë nga prodhimi, magazinimi, transferimi dhe përdorimi i lëndëve plasëse për përdorim civil.

6. "Specifikime teknike" janë specifikimet e dhëna në një dokument për karakteristikat e kërkuara për një produkt si: niveli i cilësisë, vetitë, siguria, përmasat, përfshirë edhe terminologjinë, simbolet, provat, metodat e analizave, paketimin dhe etiketimin e produktit.

7. "Transferim" është lëvizja fizike nga një vend në tjetrin e një partie lëndësh plasëse për përdorim civil.

8. "Vlerësim konformiteti" janë veprimet për përcaktimin dhe plotësimin e kërkesave teknike, të vendosura për prodhimin, magazinimin, transferimin dhe përdorimin e lëndëve plasëse për përdorim civil.

KREU II KËRKESAT KRYESORE TË SIGURISË

Neni 4

1. Lëndët plasëse për përdorim civil duhet të jenë në përputhje me kërkesat kryesore të sigurisë, që jepen dhe zbatohen ndaj tyre.

2. Çdo lëndë plasëse duhet:

a) të jetë e projektuar, prodhuar, ambalazhuar, magazinuar dhe shpërndarë në mënyrë që të mos cenojë sigurinë për jetën dhe shëndetin e njerëzve, të parandalojë dëmtimet ndaj pronës dhe mjedisit, në kushtet normale, të parashikuara, veçanërisht për rregullat e sigurisë dhe praktikatat standarde ekzistuese në kohën që ajo përdoret;

b) të ketë simbolet dhe fjalët karakteristike, në përputhje me rregullat ndërkombëtare, që përdoren për lëndët e rrezikshme, të përcaktuara nga prodhuesi për siguri dhe besueshmëri maksimale;

c) të kontrollohet në kushte reale. Nëse kontrollet nuk mund të bëhen në laborator, ato duhet të bëhen në kushtet ku lënda plasëse do të përdoret.

Neni 5

Klasifikimi për përdorim civil i lëndëve plasëse

1. Çdo lëndë plasëse për përdorim civil duhet të klasifikohet sipas partive në bazë:

a) të strukturës dhe vetive karakteristike, ku përfshihen përbërja kimike, shkalla e përzierjes dhe, aty ku është e nevojshme, përmasat dhe shpërndarja sipas masave të kokrrizave;

b) të qëndrueshmërisë kimike dhe fizike në të gjitha kushtet mjedisore, ku mund të ekspozohet, dhe pajtueshmërisë së përbërësve për qëndrueshmërinë kimike dhe fizike;

c) të ndjeshmërisë ndaj goditjeve dhe fërkimit;

ç) të pastërtisë kimike;

d) të qëndrueshmërisë ndaj ndikimit të ujit, kur është parashikuar të përdoret në lagështi ose në kushte të lagështisë dhe ku siguria e besueshmëria mund të dëmtohen rëndë nga uji;

dh) të qëndrueshmërisë ndaj temperaturave, të larta dhe të ulta, atje ku lënda plasëse është parashikuar për t'u mbajtur ose përdorur, në temperatura të tilla dhe atje ku siguria ose besueshmëria e saj mund të dëmtohet nga ftohja ose nxehja e përbërësve të lëndës plasëse;

e) të përshtatshmërisë për përdorim në mjedise të rrezikshme (për shembull mjedisi i rrezikuar nga gazi i minierës, masa të nxehta etj.), kur është parashikuar për t'u përdorur në kushte të tilla;

ë) të vetive të sigurisë, të parashikuara për të parandaluar iniciimin ose ndezjen e parakohshme ose të pakujdesshme;

f) të ngarkesës dhe funksionimit korrekt;

g) të udhëzimeve të përshtatshme në gjuhën shqipe dhe, atje ku është e domosdoshme, marketimin për trajtimin, magazinimin, përdorimin dhe asgjësimin e sigurt;

gj) të aftësisë, ambalazhit ose përbërësve të tjerë për t'i rezistuar prishjes gjatë magazinimit deri në datën e përdorimit, të përcaktuar nga prodhuesi;

h) të specifikimeve të të gjithë mekanizmave dhe aksesoreve, që nevojiten për funksionim të sigurt dhe të besueshëm;

i) të gazrave të prodhuara prej tyre, gjatë përdorimeve nëntokësore, të cilat përmbajnë monoksid karboni, gazra nitrike, gazra të tjera, avuj ose mbetje të ngurta, të ngritura në ajër vetëm në sasi që nuk dëmtojnë shëndetin;

j) të kohëve të vonësës ndërmjet kapsollave elektrike me veprim të vonuar, që duhet të jenë të mjaftueshme, uniforme, për të siguruar që mundësia e kapërcimit të kohës së detonimit nga një detonator të tjetri të jetë e sigurt;

k) të karakteristikave të kapsollave elektrike, të cilat duhet të tregohen mbi paketim (për shembull rryma e mosshpërthimit, qëndrueshmëria etj.);

l) të telave të kapsollave elektrike, që duhet të jenë të izoluara mjaftueshëm dhe me qëndrueshmëri mekanike, përfshirë edhe qëndrueshmërinë e lidhjeve në detonator, duke patur parasysh përdorimin e parashikuar.

2. Rregullat teknike (standardet) të lëndëve plasëse për përdorim civil përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Testimi i lëndëve plasëse për përdorim civil

1. Lëndët plasëse, që i përkasin sferës së veprimtarisë së këtij ligji, duhet të përmbushin kërkesat kryesore të sigurisë, të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

2. Para se një lëndë plasëse për përdorim civil të hidhet në treg, prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit janë të detyruar të kryejnë procedurat e mëposhtme të vlerësimit të konformitetit të lëndës plasëse:

a) ekzaminimin tip EC (Moduli B);

i) konformitetin tip (Moduli C);

ii) procedurën e garancisë së cilësisë së produktit (Moduli E);

iii) verifikimin e produktit (Moduli F);

b) verifikimin e produktit (Moduli G).

Të dhënat dhe kërkesat për këto module jepen në aneksin 1.

3. Prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit e lëndëve plasëse për përdorim civil, janë të detyruar t'i japin personit fizik ose juridik, të autorizuar për kryerjen e këtij vlerësimi, të gjitha të dhënat që kërkohen për vlerësimin e konformitetit.

4. Vetitë e lëndëve plasëse testohen vetëm me metoda, që plotësojnë parimet e mbrojtjes dhe të sigurisë së jetës së njerëzve, kafshëve, vlerave materiale dhe mjedisit.

5. Vetitë e lëndëve plasëse për përdorim civil testohen vetëm nga persona juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e kësaj veprimtarie, të pajisur me certifikatën e laboratorit të akredituar. Personat e autorizuar për këtë veprimtari janë të detyruar t'i demonstrojnë Ministrisë së Mbrojtjes pajtimin me praktikën e laboratorit të akredituar. Shpenzimet për testimin e lëndëve plasëse mbulohen nga prodhuesi ose importuesi.

6. Një certifikatë e pajtimit të praktikës së laboratorit të akredituar, e dhënë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, është e barazvlefshme me certifikatën e dhënë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në rast se plotëson të gjitha kushtet e parashikuara në këtë ligj.

KREU III

ADMINISTRIMI I LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL

Neni 7

1. Lëndët plasëse për përdorim civil prodhohen, importohen dhe eksportohen në Republikën e Shqipërisë vetëm me leje nga Ministria e Mbrojtjes.
2. Lëndët plasëse për përdorim civil transferohen, magazinohen dhe asgjësohen vetëm me leje nga Ministria e Rendit Publik.
3. Lëndët plasëse për përdorim civil përdoren vetëm me leje nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës.
4. Lëndët plasëse për përdorim civil futen në Republikën e Shqipërisë pasi të jenë kontrolluar nga Ministria e Mbrojtjes, e cila kryen procedurat e konformitetit të tyre.
5. Ministria e Mbrojtjes merr të gjitha masat për të kufizuar ose ndaluar hedhjen në treg të lëndëve plasëse për përdorim civil, që rrezikojnë sigurinë, edhe kur kanë të shënuar marketimin e konformitetit CE.
6. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, vendos masa të përkohshme, të domosdoshme për tërheqjen e lëndës plasëse nga tregu, ndalimin në treg dhe lëvizjen e lirë të saj.

Neni 8

Regjistrimi i lëndëve plasëse

1. Prodhuksi, importuesi dhe eksportuesi janë të detyruar të regjistrojnë lëndët plasëse, që prodhojnë dhe hedhin në treg, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
2. Në Ministrinë e Mbrojtjes mbahet regjistri shtetëror për lëndët plasëse. Dokumentet për aplikimin për regjistrim dhe mënyra e plotësimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Prodhuksi dhe importuesi janë të detyruar të njoftojnë, brenda 10 ditëve, Ministrinë e Mbrojtjes për çdo ndryshim në të dhënat e aplikimit për regjistrim.
4. Të dhënat, publikimi i të cilave dëmton prodhuesin dhe importuesin, gjatë procesit të regjistrimit, me kërkesën e tyre, specifikohen "sekret".

Neni 9

Kushtet e përgjithshme të administrimit

1. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat për dhënien e lejes, për prodhimin, importimin, eksportimin, magazinimin, transferimin, përdorimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse.
2. Ministrinë e ngarkuara, sipas nenit 7 të këtij ligji, në bazë të aplikimit me shkrim të kërkuar, i japin lejen ose autorizimin përkatës, në mbështetje të kriterëve të kualifikimit profesional dhe të gjendjes shëndetësore, personit fizik ose juridik, që ka vendbanimin në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që nuk ka kryer vepra penale.
3. Marrja e lejes nga autoritetet vendore, për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit, është kusht për administrimin e lëndëve plasëse për përdorim civil.
4. Personi fizik dhe juridik, i pajisur me leje për import ose eksport të lëndëve plasëse për përdorim civil, është i detyruar, që për çdo ngarkesë, të njoftojë 60 ditë përpara Ministrinë e Mbrojtjes.
5. Leja e dhënë nuk i transferohet personave të tjerë.

Neni 10

Mbikëqyrja e transferimeve të lëndëve plasëse

1. Këshilli i Ministrave miraton listën e materialeve plasëse për përdorim civil, që lejohen të përdoren brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Asnjë furnizues nuk mund të transferojë lëndë plasëse, nëse marrësi nuk ka autorizimin e domosdoshëm, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
3. Ministria e Mbrojtjes lëshon lejen e importimit, eksportimit dhe transferimit, në bazë të një autorizimi të vlefshëm për çdo parti malli. Ky autorizim shoqëron lëndët plasëse deri në destinacion.
4. Autorizimi, në çdo kohë, mund të pezullohet ose anulohet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

5. Ministri i Mbrojtjes miraton procedurën për marrjen, pezullimin dhe anulimin e autorizimit.

Neni 11

Dispozita të fundit

Aneksi "Vlerësimi i konformitetit" është pjesë e këtij ligji.

Neni 12

Akte të tjera të nevojshme

1. Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Rendit Publik, Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës nxjerrin udhëzimet përkatëse, në zbatim të nenit 7 pikat 1, 2 e 3 dhe nenit 10 pika 5 të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore në zbatim të nenit 5 pika 2, nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1 dhe nenit 10 pika 1 të këtij ligji.

Neni 13

Çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3933, datë 14.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

ANEKSI I

Vlerësimi i konformitetit

1. MODULI B: Ekzaminimi tip EC

1. Ky model përshkruan atë pjesë të procedurës, nëpërmjet së cilës një organ i akredituar verifikon dhe vërteton që një mostër, përfaqësuese e produktit të shqyrtuar, plotëson dispozitat përkatëse të ligjit.

2. Aplikimi i ekzaminimit tip EC paraqitet nga prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij, të ngritur brenda komunitetit, tek organi i akredituar, i zgjedhur prej tij.

Ky aplikim duhet të përfshijë:

- emrin dhe adresën e prodhuesit, nëse aplikimi paraqitet nga përfaqësuesi i tij, duhet të jepet emri dhe adresa e tij shtesë;

- një deklaratë me shkrim, që një aplikim i tillë nuk ka qenë paraqitur tek ndonjë organ tjetër i akredituar;

- dokumentet teknike, siç përshkruhet në kreun 3.

Aplikuesi duhet të vërë në dispozicion të organit të akredituar një mostër përfaqësuese të prodhimit të shqyrtuar, që këtej e tutje quhet "tip". Organi i akredituar mund të kërkojë mostra të tjera, në qoftë se nevojiten për plotësimin e programit të kontrollit.

3. Dokumentet teknike duhet të japin mundësinë e vlerësimit të konformitetit të produktit, me kërkesat e ligjit. Ato, aq sa u takon për këtë vlerësim, duhet të mbulojnë projektin, prodhimin dhe funksionimin e produktit dhe të përmbajnë aq sa duhen për vlerësim:

- një përshkrim tip të përgjithshëm;

- projektin konceptual, skicime të prodhimit dhe diagrama të komponentëve, në përmbledhje, qarqe etj.;

- përshkrime dhe shpjegime të domosdoshme, për kuptimin e skicimeve dhe diagramave dhe të funksionimit të produktit;

- një listë të standardeve kombëtare që shndërrojnë standardet e harmonizuara, të zbatuar plotësisht ose pjesërisht dhe përshkrime të zgjidhjeve të adoptuara për të plotësuar kërkesat esenciale të ligjit, atje ku standardet nuk kanë qenë zbatuar;

- rezultatet e kalkulimeve të bëra të projektit, ekzaminimet e kryera etj.;

- raportet e kontrolleve.

4. Organi i akredituar duhet:

4.1. Të ekzaminojë dokumentet teknike, të verifikojë tipin, nëse është prodhuar në konformitet me këto dokumente dhe të identifikojë elementët, që janë projektuar, në përputhje me dispozitat e standardeve, gjithashtu dhe komponentët, që janë projektuar pa zbatuar dispozitat përkatëse të këtyre standardeve.

4.2. Të kryejë ose të ketë kryer ekzaminimet përkatëse dhe testet e domosdoshme, për të kontrolluar, nëse atje ku standardet nuk janë zbatuar, nëse zgjidhjet e adoptuara nga prodhuesi, plotësojnë kërkesat e këtij ligji.

4.3. Të kryejë ose të ketë kryer ekzaminimet përkatëse dhe testet e domosdoshme, për të kontrolluar atje ku prodhuesi ka zgjedhur të zbatojë standardet përkatëse, nëse këto aktualisht janë zbatuar.

4.4. Të merret vesh me aplikantin për vendin ku do të bëhen ekzaminimet dhe testet e domosdoshme.

5. Atje ku tipi plotëson dispozitat përkatëse të këtij ligji, organi i akredituar i jep aplikantit një certifikatë ekzaminimi tip EC. Certifikata përmban emrin dhe adresën e prodhuesit, konkluzionet e ekzaminimit dhe të dhënat e domosdoshme për identifikimin e tipit të miratuar.

Një listë e pjesëve përkatëse të dokumenteve teknike i shtohet certifikatës dhe një kopje mbahet nga organi i akredituar.

Në qoftë se prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij, të ngritur në komunitet, i është refuzuar një certifikatë tip, duhet që organi i akredituar të japë arsye të hollësishme për këtë refuzim.

Veprimi duhet bërë për një procedurë apelimi.

6. Aplikuesi informon organin e akredituar për dokumentet teknike, që mban në lidhje me certifikatën ekzaminuese tip EC, të të gjitha modifikimeve të produktit të miratuar, për të marrë miratim shtesë, atje ku këto ndryshime mund të dëmtojnë konformitetin, me kërkesat esenciale ose me kushtet e përcaktuara për përdorim të produktit. Ky miratim shtesë jepet në formën e një shtojce në certifikatën ekzaminuese tip EC.

7. Çdo organ i shpallur duhet t'i komunikojë organeve të tjera të akredituara, informacionin në lidhje me certifikatën ekzaminuese dhe shtojcat e dhëna ose të anuluar.

8. Organet e tjera të akredituara mund të marrin kopjet e certifikatave ekzaminuese tip EC ose shtojcat e tyre.

9. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, i ngritur brenda komunitetit, duhet të mbajë së bashku me kopjet e dokumenteve teknike të certifikatave ekzaminuese EC dhe shtojcat e tyre, për një periudhë kohe së paku 10-vjeçare, pas datës së fundit të prodhimit të produktit të interesuar.

Detyrimi për mbajtjen e dokumenteve teknike në dispozicion është përgjegjësi e personit që vendos produktin në treg.

2. MODULI C: Konformiteti ndaj tipit

1. Ky modul përshkruan atë pjesë të procedurës, nëpërmjet së cilës prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, i ngritur brenda komunitetit, siguron dhe deklaron që lënda plasëse e interesuar është në konformitet me tipin, siç përshkruhet në certifikatën ekzaminuese tip EC dhe kënaqin kërkesat e këtij ligji, që aplikohet për to. Prodhuesi duhet të vendosë shenjë CE në çdo lëndë plasëse dhe përpilon një deklaratë me shkrim për konformitetin.

2. Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar që procesi i prodhimit siguron konformitet të produktit të prodhuar me tipin, siç përshkruhet në certifikatën ekzaminuese tip EC dhe me kërkesat kryesore të sigurisë.

3. Prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij duhet të mbajë një kopje të deklaratës të konformitetit për një periudhë së paku 10-vjeçare, pas datës së fundit të prodhimit të produktit.

Detyrimi për mbajtjen e dokumentave teknike në dispozicion është përgjegjësi e personit që

vendos produktin në treg.

4. Një organ i akredituar, i zgjedhur nga prodhuesi, duhet të kryejë ekzaminime të produktit në intervale jo të rregullta. Një mostër e përshtatshme e produktit të përfunduar, e marrë në vendin e prodhimit nga organi i akredituar, ekzaminohet dhe kontrollohet, siç përcaktohet në standardin e aplikuar, ose në standardin e harmonizuar, ose kryhen kontrole ekuivalente për të kontrolluar konformitetin e produktit me kërkesat e ligjit korrespondues. Organi i akredituar duhet të marrë masat e duhura në rastin kur një ose më shumë mostra të ekzaminuara nuk janë në konformitet.

Nën përgjegjësinë e organit të akredituar, prodhuesi duhet të vendosë simbolin e identifikimit të organit akreditues gjatë procesit të prodhimit.

3. MODULI D: Garancia e cilësisë së prodhimit

1. Ky model përshkruan procedurën, nëpërmjet së cilës prodhuesi, që kënaq detyrimet e harmonizimit të ligjeve, të lidhura me lëndët plasëse, siguron dhe deklaron që lënda plasëse është në konformitet me tipin, siç përshkruhet në certifikatën ekzaminuese tip EC dhe kënaqin kërkesat e këtij ligji. Prodhuesi vendos shenjë CE në çdo lëndë plasëse dhe përpilon një deklaratë me shkrim për konformitetin. Shenja CE shoqërohet me simbolin e identifikimit të organit të akredituar, të përgjegjshëm për kontrollet.

2. Prodhuesi duhet të punojë me një sistem cilësie të miratuar për prodhimin me inspektim të produktit të përfunduar dhe me testimet përkatëse.

3. Sistemi i cilësisë.

3.1. Prodhuesi paraqet një aplikacion për vlerësimin e sistemit të vet të cilësisë, për lëndët plasëse të interesuara, tek organi i akredituar, i zgjedhur prej tij.

Aplikimi duhet të përmbajë:

- gjithë informacionin përkatës për kategorinë e lëndës plasëse të shqyrtuar;
- dokumentet në lidhje me sistemin e cilësisë;
- dokumentet teknike që i përkasin tipit të miratuar dhe një kopje të certifikatës ekzaminuese tip EC.

3.2. Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë konformitetin e lëndëve plasëse me tipin, siç përshkruhet në certifikatën ekzaminuese tip EC dhe me kërkesat e këtij ligji që aplikohet ndaj tyre.

Të gjitha dokumentet, kërkesat dhe dispozitat e adoptuara nga prodhuesi, duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike. Dokumentet e sistemit të cilësisë duhet të lejojnë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve dhe manualeve.

Në mënyrë të veçantë duhet të përmbajë një përshkrim të:

- objektivave të cilësisë dhe strukturën organizative, përgjegjësi dhe fuqinë e drejtimit në lidhje me cilësinë e lëndëve plasëse;
- prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe teknikave të garantimit të cilësisë, proceseve dhe veprimeve sistematike që do të përdoren;
- ekzaminimeve dhe testeve që do të kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit, si dhe frekuencës me të cilën ato do të kryhen;
- dokumentimeve të cilësisë, si për shembull, raportet e inspektimit dhe të dhënave të testit, të dhënave të kalibrimit, raporteve të kualifikimit të personelit të interesuar etj.;
- mënyrave të monitorimit dhe arritjes së cilësisë së kërkuar të lëndës plasëse dhe veprimeve efektive të sistemit të cilësisë.

3.3. Organi i akredituar duhet të vlerësojë sistemin e cilësisë, për të përcaktuar nëse ai kënaq kërkesat për të cilat flitet në 3.2. Ai duhet të presupozojë konformitet me këto kërkesa, në lidhje me sistemet e cilësisë, që përmbushin standardin e harmonizuar përkatës. Ekipi i kontrollit duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë për vlerësimin e teknologjisë së produktit përkatës. Procedura e vlerësimit përfshin një njohje me ambientet e prodhuesit.

Vendimi i njoftohet prodhuesit. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e vlerësimit.

3.4. Prodhuesi duhet të marrë përsipër të plotësojë detyrimet, që rrjedhin nga sistemi i cilësisë i miratuar dhe zbatojë atë në nivelin e kërkuar.

Prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij duhet të mbajë të informuar organin e akredituar,

që e ka miratuar sistemin e cilësisë, mbi çdo ndryshim të propozuar në sistemin e cilësisë.

Organi i akredituar duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendosë, që sistemi i cilësisë, i ndryshuar, kënaq kërkesat për të cilat flitet në paragrafin 3.2., ose nëse kërkohet një rivlerësim.

Ai duhet të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Vendimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e vlerësimit konkret.

4. Monitorimi nën përgjegjësinë e organit të akredituar.

4.1. Qëllimi i monitorimit është që të bëhet e sigurt që prodhuesi përmbush siç duhet detyrimet, që dalin nga sistemi i cilësisë së miratuar.

4.2. Prodhuesi duhet të lejojë hyrjen e organit të akredituar, për qëllime inspektimi, ndaj prodhimit dhe magazinimit dhe t'i japë atij të gjithë informacionin e domosdoshëm, sidomos:

- dokumentet e sistemit të cilësisë;

- dokumentimet e cilësisë, si për shembull, raportet e inspektimit dhe të dhënat e kontrollit, të dhënat e kalibrimit, raporte të kualifikimit të personelit të interesuar etj.

4.3. Organi i akredituar duhet periodikisht të kryejë kontrolle, për të siguruar që prodhuesi mban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe i jep prodhuesit raportin e kontrollit.

4.4. Përveç kësaj, organi i akredituar mund të bëjë te prodhuesi kontrolle të panjoftuara. Gjatë këtyre kontrolleve, organi i akredituar verifikon funksionimin e sistemit të cilësisë dhe në qoftë se e shikon të domosdoshme, organi i akredituar i jep prodhuesit një raport për kontrollin dhe një raport mbi testin e prodhimit.

5. Prodhuesi duhet të mbajë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për një periudhë së paku 10-vjeçare pas datës së fundit të prodhimit të produktit:

- dokumentin për të cilin flitet në nënparagrafin e 3.1;

- rinovimin e fundit për të cilin bëhet fjalë në paragrafin e dytë të 3.4;

- vendimet dhe formularët e raporteve të organit të akredituar, për të cilin flitet në paragrafin e fundit të 3.4, në 4.3 dhe në 4.4.

6. Çdo organ i akredituar duhet t'i japë organeve të tjera të akredituara informacionin përkatës, në lidhje me aprovimet e dhëna dhe të anuluarat të sistemit të cilësisë.

4. MODULI E: Garancia e cilësisë së produktit

1. Ky modul përshkruan procedurën, nëpërmjet së cilës prodhuesi kënaq detyrimet për harmonizimin e ligjeve, të lidhura me lëndët plasëse, siguron dhe deklaron që lëndët plasëse janë në konformitet me tipin, siç përshkruhet në certifikatën ekzaminuese tip EC. Prodhuesi duhet të vendosë shenjën CE në çdo lëndë plasëse dhe të përpilojë një deklaratë me shkrim të konformitetit. Shenja CE duhet të shoqërohet me simbolin e identifikimit të organit të akredituar, të përgjegjshëm për kontrollin, për të cilat flitet në kreun IV.

2. Prodhuesi duhet të zbatojë një sistem cilësie të miratuar, për inspektimin dhe kontrollin e lëndës plasëse të përfunduar, siç specifikohet në Kreun III. Ai duhet të jetë subjekt i kontrolleve, për të cilat flitet në Kreun IV.

3. Sistemi i cilësisë

3.1. Prodhuesi paraqet një aplikim tek organi i akredituar, i zgjedhur prej tij për vlerësimin e sistemit të cilësisë për lëndën plasëse të tij. Aplikimi duhet të përmbajë:

- informacionin përkatës për kategorinë e lëndës plasëse që shqyrtohet;

- dokumentin e sistemit të cilësisë;

- dokumentet teknike që i përkasin tipit të miratuar dhe një kopje të certifikatës ekzaminuese EC.

3.2. Sipas sistemit të cilësisë, çdo lëndë plasëse ekzaminohet dhe kontrollon si duhet, siç përcaktohet në standardet, ose bëhen teste ekuivalente me qëllim që të verifikohet konformiteti i tij me kërkesat përkatëse të ligjit. Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e adoptuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen në një mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe instruksioneve të shkruara. Ky dokumentim i sistemit të cilësisë duhet të japë mundësinë për t'u interpretuar në një mënyrë uniforme programet, manualët dhe regjistrimet e cilësisë.

Në veçanti ajo duhet të përmbajë një përshkrim të:

- objektivave të cilësisë dhe të strukturës organizative të përgjegjëseve dhe fuqive të drejtimit

në lidhje me cilësinë e produktit;

- ekzaminimet dhe testet që do të bëhen pas prodhimit;
- mënyrave të monitorimit dhe veprimeve efektive të sistemit të cilësisë;
- dokumentimeve të cilësisë si, për shembull, të raporteve të inspektimit dhe të dhënave të kontrollit, të raporteve të kualifikimit e personelit të interesuar etj.

3.3. Organi i akredituar duhet të vlerësojë sisemin e cilësisë për të përcaktuar, nëse ai kënaq kërkesat, për të cilat flitet në 3.2. Duhet të presupozohet konformitet me këto kërkesa, në lidhje me sistemet e cilësisë dhe përmbushje të standardit përkatës të harmonizuar.

Një ekip kontrolli duhet të ketë së paku një anëtar me eksperiencë për vlerësimin e teknologjisë të produktit përkatës. Procedura e vlerësimit duhet të përfshijë një inspektim në ambientet e prodhuesit. Prodhuesi duhet të njoftohet për vendimin. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e vlerësimit konkret.

3.4. Prodhuesi duhet të marrë përsipër për të plotësuar detyrimet, që dalin nga sistemi i cilësisë së miratuar, për ta mbajtur atë në nivelin e kërkuar. Prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij duhet të mbajnë të informuar organin e akredituar që e ka miratuar sistemin e cilësisë, për çdo ndryshim në këtë sistem të cilësisë.

Organi i akredituar duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendosë nëse sistemi i cilësisë me këto ndryshime kënaq akoma kërkesat, për të cilat flitet në 3.2 ose në se një rivlerësim është i nevojshëm.

Ai duhet të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e vlerësimit konkret.

4.1. Qëllimi i monitorimit është për të bërë të sigurt që prodhuesi plotëson si duhet detyrimet që dalin nga sistemi i cilësisë së miratuar.

4.2. Prodhuesi duhet të lejojë hyrjen e organit të akredituar për qëllime inspektimi, testimi dhe magazinimi dhe duhet t'i japë atij të gjithë informacionin e domosdoshëm, sidomos :

- dokumentimin e sistemit të cilësisë;
- dokumentet teknike;
- regjistrimet e cilësisë si, për shembull, raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrit, raportet e kualifikimit të personelit të interesuar etj.

4.3. Organi i akredituar duhet që periodikisht të bëjë kontrole për të siguruar që prodhuesi mban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i japë prodhuesit një raport mbi kontrollin.

4.4. Përveç kësaj, organi i akredituar mund të bëjë te prodhuesi kontrole të panjoftuara. Gjatë këtyre kontrolleve, organi i akredituar bën teste për të verifikuar, që sistemi i cilësisë funksionon korrekt dhe, në rast se e sheh të domosdoshme, organi i akredituar i jep prodhuesit një raport mbi kontrollin dhe një raport mbi testin e bërë.

5. Prodhuesi duhet të mbajë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për një periudhë jo më pak se 10 vjet këto dokumente:

- dokumentet, për të cilat flitet në paragrafin 3.1;
- ndryshimet, për të cilat flitet në paragrafin 3.4;
- vendimet dhe raportet e organit të akredituar, për të cilat flitet në paragrafin e fundit 3.4, 4.3 dhe 4.4.

6. Çdo organ i akredituar duhet të dërgojë tek organet e tjera të akredituara informacionin përkatës në lidhje me aprovimet e dhëna dhe të anuluar të sistemit të cilësisë.

MODULI F : Verifikimi i produktit

1. Ky modul përshkruan procedurën nëpërmjet të cilës një prodhues ose përfaqësues i autorizuar i tij, i ngritur brenda komunitetit, kontrollon dhe vërteton që lëndët plasëse, që janë subjekt i dispozitave të këtij ligji, janë në konformitet me tipin, siç përshkruhet në certifikatën ekzaminuese tip EC dhe kënaqin kërkesat përkatëse të ligjit.

2. Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e domosdoshme, me qëllim që procesi i prodhimit të sigurojë konformitet të lëndëve plasëse, me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EC dhe me kërkesat e ligjit, që aplikohen ndaj tyre. Ai duhet të vendosë shenjën CE në çdo lëndë plasëse dhe duhet të përpilojë një deklaratë të konformitetit.

3. Organi i akredituar duhet të bëjë ekzaminimet dhe testet e duhura, me qëllim që të

kontrollojë konformitetin e lëndës plasëse me kërkesat përkatëse të ligjit, nëpërmjet ekzaminimit dhe testimit të çdo lënde plasëse, siç përshkruhet në nenin 4.

Prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij duhet të mbajë një kopje të deklaratës së konformitetit, për një periudhë së paku 10-vjeçare pas lëndës plasëse të fundit, që ka qenë prodhuar.

4. Verifikimi nëpërmjet ekzaminimit dhe testimit të çdo lënde plasëse.

4.1. Të gjitha lëndët plasëse duhet të jenë të ekzaminuara individualisht dhe testuar, siç përcaktohet në standardin përkatës, për të cilat flitet në nenin 4 ose bëhen testime ekuivalente, me qëllim që të verifikohet konformiteti i tyre me tipin përkatës dhe kërkesat e ligjit.

4.2. Organi i akredituar duhet të vendosë ose imponon vendosjen e simbolit të identifikimit të tij në çdo lëndë plasëse të miratuar dhe përpilon një certifikatë të konformitetit, në lidhje me testimet e bëra.

4.3. Prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij duhet të sigurojnë që ai është në gjendje të japë certifikatën e organit të akredituar kur i kërkohet.

MODULI G : Verifikimi i njësisë

1. Ky modul përshkruan procedurën, nëpërmjet së cilës prodhuesi siguron dhe deklaron që lënda plasëse, së cilës i është lëshuar certifikata për të cilën flitet në Kreun II, është konform kërkesave përkatëse të ligjit. Prodhuesi duhet të vendosë shenjën CE në lëndën plasëse dhe të përpilojë një deklaratë të konformitetit.

2. Organi i akredituar duhet të ekzaminojë lëndën plasëse dhe të bëjë testet e duhura, siç përcaktohet në standardin përkatës ose të bëjë teste ekuivalente, për të siguruar konformitetin e tij me kërkesat përkatëse të ligjit.

Organi i akredituar duhet të vendosë ose imponojë vendosjen e simbolit të identifikimit mbi lëndën plasëse të miratuar dhe të përpilojë një certifikatë të konformitetit në lidhje me testet e bëra.

3. Synimi i dokumenteve teknike është për të dhënë mundësi, që të vlerësohet konformiteti me kërkesat e ligjit dhe që të kuptohet projekti, prodhimi dhe funksionimi i lëndës plasëse.

Dokumentet duhet të përmbajnë aq sa është e domosdoshme për vlerësim:

- një përshkrim të përgjithshëm të tipit;
- projektin konceptual dhe skicat e prodhimit e skemën e komponentëve etj.;
- përshkrimet dhe shpjegimet e domosdoshme për kuptimin e skicave të thëna më sipër, skemat dhe funksionimin e lëndës plasëse ose sistemin e mbrojtjes;
- një listë të standardeve të zbatuara plotësisht ose pjesërisht dhe përshkrimet e zgjidhjeve të adoptuara, për të plotësuar kërkesat esenciale të ligjit, atje ku këto standarde nuk kanë qenë plotësuar;
- rezultatet e bëra të kalkulimeve të projektit, ekzaminimit e bëra etj.;
- raportet e testit.

L I G J

Nr.9128, datë 29.7.2003

PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË FINANCIAR TË PILOTËVE FLUTURUES NË PENSION

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë një trajtim financiar të pilotëve, që kanë fluturuar me avionë reaktivë e me avionë me helikë, në shtesë të pensionit të pleqërisë, të cilin e përfitojnë nga sigurimi shoqëror i detyrueshëm, në momentin e lindjes së të drejtës së përfitimit të këtij trajtimi.

Neni 2
Baza e llogaritjes

Paga referuese është bazë për llogaritjen e këtij trajtimi financiar të veçantë.

Me pagë referuese, për efekt të këtij ligji, kuptohet paga bazë për funksionin, plus shpërblimin për gradën, të njëzuar me pagën referuese të funksionit organik të ushtarakut aktiv në të njëjtën detyrë me përfituesin, në momentin e lindjes së të drejtës për trajtim financiar të veçantë.

Neni 3
Financimi dhe llogaritja e përfitimit

Efektet financiare që rrjedhin nga ky ligj përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Pagimi dhe caktimi i përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Mënyra e llogaritjes së përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4
Kushtet e përfitimit

Pilotët, të cilët kanë fluturuar me avionë reaktivë e avionë me helikë dhe që kanë plotësuar ose plotësojnë kushtet për pension pleqërie, përfitojnë, përveç pensionit të pleqërisë, një trajtim të veçantë financiar në shtesë të pensionit në masën:

1. 50 për qind të pagës referuese që ka pasur përfituesi në çastin e daljes në rezervë, lirim ose pension pleqërie:

- a) kur piloti ka fluturuar me avionë reaktivë jo më pak se 12,5 vjet kalendarikë;
- b) kur piloti ka fluturuar me avionë me helikë jo më pak se 16,5 vjet kalendarikë.

2. 35 për qind të pagës referuese që ka pasur përfituesi në çastin e daljes në rezervë, lirim ose pension pleqërie:

- a) kur piloti ka fluturuar me avionë reaktivë jo më pak se 8,5 vjet kalendarikë;
- b) kur piloti ka fluturuar me avionë me helikë jo më pak se 12,5 vjet kalendarikë.

3. 25 për qind të pagës referuese që ka pasur përfituesi në çastin e daljes në rezervë, lirim ose pension pleqërie, për funksionet aviondrejtues fluturues, qitës-radist, radist, teknik, fluturues bordi, me jo më pak se 15 vjet vjetërsi në shërbim, pavarësisht nga koha e daljes në pension.

Neni 5
Shuma e pensionit

Shuma e pensionit të plotë të pleqërisë plus masën e trajtimit të veçantë financiar, sipas këtij ligji, nuk mund të jetë më e madhe se 50 për qind e pagës referuese të pilotit fluturues, kur ka dalë në rezervë, lirim ose pension pleqërie.

Masa e trajtimit të veçantë të pilotëve fluturues indekskohet sa herë që indeksohen pensionet e pleqërisë.

Neni 6
Njësimi i funksioneve

Kur funksionet organike, në çastin kur piloti fluturues ka dalë në rezervë, lirim ose pension pleqërie, nuk ekzistojnë më në strukturën e Forcave të Armatosura, Ministri i Mbrojtjes bën njësimin e

tyre, për efekt të pagës referuese, me funksionet organike që ekzistojnë në Forcat e Armatosura, në çastin kur pilotit i lind e drejta e përfitimit të këtij trajtimi.

Neni 7

Dispozita kalimtare

Pilotëve fluturues, që u lind e drejta për përfitimin e trajtimit të veçantë, sipas këtij ligji dhe përfitojnë njëkohësisht nga neni 12 i ligjit nr.8087, datë 1.3.1996 “Për sigurimin suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, kanë të drejtë të zgjedhin ndërmjet trajtimit të veçantë dhe pensionit suplementar të pleqërisë.

Neni 8

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3935, datë 14.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

"NDREQJE GABIMI

Në ligjin nr.9087 datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" botuar në Fletoren Zyrtare nr.52, në nenin 22 hiqen fjalët "c), ç)".

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 19.8.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë